



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 75

Tiranë – E premte, 2 maj 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 116, datë 23.4.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 8131
Dekret i Presidentit nr. 117, datë 23.4.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 8131
Dekret i Presidentit nr. 118, datë 23.4.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 8131
Dekret i Presidentit nr. 119, datë 23.4.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 8131
Dekret i Presidentit nr. 120, datë 23.4.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 8132
Dekret i Presidentit nr. 121, datë 23.4.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 8132
Dekret i Presidentit nr. 122, datë 23.4.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 8132
Dekret i Presidentit nr. 123, datë 23.4.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 8133
Dekret i Presidentit nr. 124, datë 23.4.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 8133
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 10, datë 18.4.2025	Për disa shtesa në udhëzimin nr. 23, datë 9.12.2014, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, i ndryshuar..... 8133

Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 62, datë 18.4.2025	Për një shtesë në urdhrin nr. 163, datë 26.3.2021, “Për përcaktimin e masave të detajuara për zbatimin e standardeve themelore të përbashkëta në fushën e sigurisë së aviacionit civil”.....	8134
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 3.4.2025	Rrapo Danushi dhe të tjerët kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 33547/08</i>).....	8135
Vendim i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 1, datë 30.4.2025	Për përcaktimin e shteteve që sigurojnë një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale.....	8138
Udhëzim i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 1, datë 30.4.2025	Për masat e sigurisë për të dhënat personale në fushën e arsimit.....	8139
Udhëzim i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 2, datë 30.4.2025	Për mbrojtjen e të dhënave personale shëndetësore	8141
Udhëzim i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 3, datë 30.4.2025	Për përpunimin e të dhënave personale nga sistemet e videosurvejimit..	8146
Udhëzim i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 4, datë 30.4.2025	Për mbrojtjen e të dhënave personale dhe masat e duhura të sigurisë në marketingun e drejtpërdrejtë.....	8150
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 112/10, datë 28.4.2025	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i linjës 110 kV Gjiri i Lalzit–Fushë-Kuqe”.....	8153

**DEKRET****Nr. 116, datë 23.4.2025****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Davide Alberto Amatucci
2. Dhurata Mazllum Ramadani
3. Benita Albert Batalli Kadriqeli

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 117, datë 23.4.2025****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetas:

1. Bianca Uwe Kröger Resulaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 118, datë 23.4.2025****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Hata Zenun Nikçi
2. Albulena Arben Kusari

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 119, datë 23.4.2025****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,



DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:

1. Zana Sedat Avdiu

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 120, datë 23.4.2025

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:

1. Sona Elbrus Hidri

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 121, datë 23.4.2025

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Hasan Mujo Hasani
2. Blerta Shefki Ramadani Isufi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 122, datë 23.4.2025

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Suat Celal Kiyan



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 123, datë 23.4.2025

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Nevedet Adem Ponosheci
2. Berran Engyl Pallush

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 124, datë 23.4.2025

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Donjeta Zija Rexha (Vardari)
2. Marsi Andrea Boshkoviç

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

UDHËZIM
Nr. 10, datë 18.4.2025

**PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN
NR. 23, DATË 9.12.2014, “PËR
MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË
DETYRUESHME TË SIGURIMEVE
SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE”,
I NDRYSHUAR**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10 383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ministri i Financave

UDHËZON:

1. Në pikën 10.8, të pikës 10, “Të tjera”, të udhëzimit nr. 23, datë 9.12.2014, pas kategorisë 39, shtohen kategoritë 40 dhe 41, me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“- Kategoria 40. Personat e punësuar me profesion në fushën e teknologjisë së informacionit



(IT) dhe të regjistruar në subjektet me aktivitet kryesor në fushën e teknologjisë së informacionit, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre sipas ligjit nr. 58/2022, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore”.

- Kategoria 41. Personat e punësuar në subjektet zhvilluese që ushtrojnë aktivitetin e tyre sipas ligjit nr. 58/2022, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore”.”

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCEVE
Petrit Malaj

URDHËR
Nr. 62, datë 18.4.2025

PËR NJË SHITESË NË URDHRIN
NR. 163, DATË 26.3.2021, “PËR
PËRCAKTIMIN E MASAVE TË
DETAJUARA PËR ZBATIMIN E
STANDARDEVE THEMELORE TË
PËRBASHKËTA NË FUSHËN E
SIGURISË SË AVIACIONIT CIVIL”¹

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, shkronja “ç”, dhe nenit 113, pika 2, të ligjit nr. 96/2020, datë 23.7.2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin nr. 163, datë 26.3.2021, “Për përcaktimin e masave të detajuara për zbatimin e standardeve themelore të përbashkëta në fushën e sigurisë së aviacionit civil” pas pikës 2, shtohet pika 2/1, me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“2/1 Kriteret për shmangien nga standardet themelore të përbashkëta të sigurisë në aviacion dhe zbatimin e masave alternative, janë sipas aneksit 2

bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij urdhri.”.

2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR DHE
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË
Belinda Balluku

ANEKS 2
KRITERET PËR SHMANGIEN NGA
STANDARDET THEMELORE TË
PËRBASHKËTA TË SIGURISË NË
AVIACION DHE ZBATIMIN E MASAVE
ALTERNATIVE

1. Autoriteti i Aviacionit Civil (“AAC”) mund të propozojë shmangien nga standardet themelore të përbashkëta të sigurisë në aviacion (standardet bazë), të përcaktuara në nenin 4 të VKM-së nr. 821, datë 24.12.2021, “Për përcaktimin e standardeve bazë për ruajtjen e aviacionit civil nga aktet e ndërhyrjes së paligjshme, që rrezikojnë sigurinë e aviacionit civil”, si dhe masat alternative të sigurisë në aviacion që do të zbatohen, të cilat do të mundësojnë një nivel të përshtatshëm të mbrojtjes, mbi bazën e një vlerësimi të riskut të miratuar nga AAC-ja, në aeroportet ose pjesë të ndara të aeroporteve në territorin e Republikës së Shqipërisë ku trafiku kufizohet në një ose më shumë prej kategorive të mëposhtme:

1.1 Avion me peshë maksimale në ngritje më pak se 15 000 kilogramë;

1.2 Helikopterët;

1.3 Fluturime shtetërore, ushtarake dhe të agjencive ligjzbatuese;

1.4 Fluturime për shuarjen e zjarrit;

1.5 Fluturime për shërbimet mjekësore, emergjencë ose shërbime të shpëtimit;

1.6 Fluturime për kërkim dhe zhvillim;

1.7 Fluturime për punë ajrore;

1.8 Fluturime të ndihmës humanitare;

1.9 Fluturime të operuara nga transportuesit

¹ Ky urdhër përaftron plotësisht rregulloren e Komisionit (BE) nr. 1254/2009, datë 18 dhjetor 2009 që vendos kriteret për lejimin e shteteve anëtare të BE-së të heqin dorë nga zbatimi i standardeve themelore të përbashkëta mbi sigurinë e aviacionit civil dhe të miratojnë masa alternative të sigurisë, Faqe | 8134

botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së L 338, 19.12.2009, e ndryshuar me rregulloren e Komisionit (BE) nr. 2016/2096, datë 30 nëntor 2016, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së L 326, 1.12.2016.



ajror, prodhuesit e avionëve ose kompanitë e mirëmbajtjes, që nuk transportojnë as pasagjerë e bagazhe dhe as mallra e postë ajrore;

1.10 Fluturime me avion me peshë maksimale në ngritje më pak se 45 500 kilogramë, në pronësi të një shoqërie për transportin e personelit të vet dhe të pasagjerëve dhe mallrave pa pagesë si një ndihmë për kryerjen e biznesit të shoqërisë;

1.11 Fluturimet me avionë me një peshë maksimale në ngritje më pak se 45 500 kilogramë, të marrë me marrëveshje *charter* ose me qira në tërësinë e tij nga një shoqëri, nga një operator avioni me të cilin ka një marrëveshje me shkrim për transportin e personelit të vet dhe të pasagjerëve dhe mallrave pa pagesë si një ndihmë për kryerjen e biznesit të shoqërisë;

1.12 Fluturimet me avionë me një peshë maksimale në ngritje më pak se 45 500 kilogramë, për transportin e pronarit të avionit dhe të pasagjerëve e mallrave pa pagesë.

2. Për fluturimet e përmendura në pikat 1.10, 1.11 dhe 1.12, por me një peshë maksimale në ngritje prej 45 500 kilogramë ose më shumë, Autoriteti i Aviacionit Civil mundet në raste të jashtëzakonshme, dhe bazuar në një vlerësim të riskut për çdo rast individual, të propozojë heqjen e kufizimit të peshës të përcaktuar në këto kategori. Shtetet anëtare të ZPAE-së që presin fluturime të tilla me 45 500 kilogramë ose më shumë mund të kërkojnë njoftim paraprak, i cili mund të përfshijë një kopje të vlerësimit të riskut të kryer ose miratimit të tyre paraprak. Kërkesa për njoftim ose miratim paraprak do t'u dorëzohet me shkrim të gjitha shteteve të tjera anëtare të ZPAE-së.

3. Masat alternative në rast të shmangies zbatohen pas miratimit nga ministri.

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 33547/08
Rrapo Danushi dhe të Tjerët
kundër Shqipërisë
(shihni tabelën bashkëngjitur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 13 mars 2025, si Komitet i përbërë nga:

Oddný Mjöll Arnardóttir, *kryetar,*

Úna Ní Raifeartaigh,

Mateja Đurović, *gjyqtarë,*

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendëskancelare në detyrë e Seksionit,*

Duke pasur parasysh kërkesën më sipër të depozituar më 10 qershor 2008,

Duke pasur parasysh deklaratën e paraqitur nga Qeveria e paditur me të cilën i kërkon Gjykatës të heqë kërkesën nga lista e çështjeve,

Pas diskutimit, vendosi si më poshtë:

FAKTE DHE PROCEDURA

Lista e kërkuessve jepet në tabelën bashkëngjitur. Kërkuessit u përfaqësuan nga z. S. Puto, avokat i licencuar në Tiranë.

Më 15 tetor 2004, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë vendosi në favor të kërkuessve dhe urdhëroi një palë private që të prishë ndërtesat pa leje dhe të lirojë dhe të pastrojë një truall toke me sipërfaqe 27.500 m² në bashkëpronësi të kërkuessve ("vendimi i vitit 2004"). Gjykata e Apelit Vlorë la në fuqi vendimin më 4 tetor 2005. Kërkuessit depozituan një kërkesë në zyrë përmbartimore, e cila për disa vite u përpoq pa sukses të ekzekutonte vendimin.

Ndërtesat u prishën vetëm në dhjetor 2011 dhe kërkuessi i parë mori tokën në posedim. Më 30 dhjetor 2011 përmbartuesi ndërpreu procedurën e ekzekutimit me arsyetimin që vendimi gjyqësor ishte ekzekutuar i plotë.

Ankimet e kërkuessve sipas nenit 6 paragrafit 1 të Konventës dhe nenit 1 të protokollit 1, në lidhje me nenin 13 të Konventës për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të vitit 2004 në favor të tyre i ishin komunikuar qeverisë shqiptare ("Qeveria").

LEGJISLACIONI

Kërkuessi i parë dhe i dytë ndërrojnë jetë më 9 shkurt 2010 dhe më 27 shkurt 2021, përkatësisht. Z. Jurgen Zenaj, trashëgimtari i kërkuessit të parë dhe të dytë, shprehur dëshirën e tij për të ndjekur procesin në vend të tyre. Gjykata pranon dhe Qeveria nuk kundërshton që z. Jurgen Zenaj ka interes legjitim në ndjekjen e kërkesës në vend të kërkuessit të parë dhe të dytë.

Pas negociimit të pasuksesshëm për zgjidhje miqësore, Qeveria informoi Gjykatën që ajo propozonte të bënte një deklaratë të njëanshme, me qëllim zgjidhjen e problemeve të ngritura në këtë ankim për kohëzgjatjen e procedurës së ekzekutimit. Më tej, ajo i kërkoj Gjykatës të çregjistronte kërkesën në përputhje me nenin 37 të Konventës.



Qeveria pranoi që të drejtat e kërkuarve sipas nenit 6 dhe 13 të Konventës dhe sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 ishin shkelur si pasojë e mosekzekutimit të tejzgjatur të vendimit të brendshëm në favor të tyre. Ajo u ofrua që të paguajë shumën e detajuar në tabelën bashkëngjitur dhe ftoi Gjykatën të çregjistrojë kërkesën nga lista e çështjeve në përputhje me paragrafin 1(c) të nenit 37 të Konventës.

Shuma duhet të konvertohet në monedhën e Shtetit të paditur me kursin e këmbimit të datës së pagesës, dhe duhet të paguhet brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të Gjykatës. Në rast të mospagimit të kësaj shume brenda periudhës tre mujore të lartpërmendur, Qeveria merr përsipër të paguajë një kamatëvonesë të thjeshtë nga momenti i mbarimit të kësaj periudhe deri në momentin e shlyerjes, me një normë të barabartë me normën marxhinale të huadhënies të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre pikë përqindjeje.

Pagesa do të përbëjë zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

Gjykata nuk mori përgjigjen miratuese nga pala kërkuar për deklaratën e Qeverisë.

Gjykata vëren që neni 37 § 1 (c) mundëson çregjistrimin e një çështjeje nga lista e saj:

“... për çdo arsye tjetër që, sipas Gjykatës, nuk justifikon vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës”.

Prandaj, ajo mund të çregjistrojë kërkesën sipas nenit 37 § 1 (c) bazuar në një deklaratë të njëanshme nga një Qeveri e paditur edhe nëse kërkuarët dëshirojnë vazhdimin e shqyrtimit të çështjes (shihni në veçanti, *Çështja Tabsin Acar kundër Turqisë* vendimi (kundërshtime paraprake) [DHM], nr. 26307/95, §§ 75–77, GJEDNJ 2003-VI).

Gjykata ka krijuar praktikë gjyqësore të qartë dhe të zgjeruar në lidhje me ankimet për mosekzekutimin ose ekzekutimin me vonesë të vendimeve të brendshme (shihni, për shembull *Qufaj Co. sh.p.k. kundër Shqipërisë*, nr. 54268/00, 18 nëntor 2004, dhe *Gjyli kundër Shqipërisë*, nr. 32907/07, 29 shtator 2009).

Gjykata e gjen të provuar që vendimi gjyqësor i vitit 2004 ishte ekzekutuar i plotë në dhjetor 2011.

Më 30 dhjetor 2011 përmbaruesi mbylli procedurën e ekzekutimit në lidhje me ekzekutimin e plotë të vendimit gjyqësor. Kërkuarët as nuk e kundërshtuan atë vendim përpara gjykatave të brendshme, as nuk paraqitën ndonjë provë në gjykatë që nuk ishte ekzekutuar vendimi gjyqësor i vitit 2004.

Duke pasur parasysh pranimet që përmban deklarata e Qeverisë, si edhe faktin që vendimi përfundimtar në favor të kërkuarve ishte ekzekutuar i plotë, dhe duke pasur parasysh shumën e propozuar të kompensimit – që është në përputhje me shumën e dhëna në çështje të ngjashme – Gjykata vlerëson që nuk justifikohet më tej vazhdimi i shqyrtimit të kërkesës (neni 37 § 1 (c)).

Nisur nga vlerësimet e mësipërme, Gjykata është e bindur që respektimi i të drejtave të njeriut siç përcaktohet në Konventë dhe protokollet e saj nuk kërkon që ajo të vazhdojë të shqyrtojë kërkesën (neni 37 § 1 *in fine*).

Në përfundim, Gjykata thekson që nëse Qeveria nuk përmbush kushtet e deklaratës së saj të njëanshme, kërkesa mund të futet përsëri në listë në përputhje me paragrafin 2 të nenit 37 të Konventës (shihni *Çështja Josipović kundër Serbisë* (vendim), nr. 18369/07, 4 mars 2008).

Nisur nga sa më sipër, kërkesa duhet të hiqet nga lista e çështjeve të Gjykatës.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht:

Vendos që z. Jurgen Zenaj, trashëgimtar i kërkuarët të parë dhe të dytë, legjitimohet për të ndjekur kërkesën në vend të tyre;

Mban parasysh kushtet e deklaratës së Qeverisë së paditur dhe rregullimet për të siguruar përmbushjen e angazhimeve të përmendura në të;

Vendos të çregjistrojë kërkesën nga lista e saj e çështjeve në përputhje me nenin 37 § 1 (c) të Konventës.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 3 prill 2025.

Viktoriya Maradudina
ZËVENDËSKANCELARE
NË DETYRË

Oddný Mjöll
Arnardóttir
KRYETAR



SHTOJCË

Kërkesa që paraqet ankimet sipas paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës
(mosekzekutimi ose ekzekutimi me vonesë i vendimeve të brendshme)

Kërkesa nr. Data e paraqitjes	Emri i kërkuarit Viti i lindjes	Emri dhe vendndodhja e përfaqësuesit	Data e marrjes së deklaratës së Qeverisë	Data e marrjes së komenteve të kërkuarëve,	Shuma e caktuar për dëmin jopasuror dhe kosto, dhe shpenzime (në euro) ²
33547/08 10.6.2008 (11 kërkuarë)	Rrapo DANUSHI 1932 Ndërruar jetë në vitin 2021 Fejzie DANUSHI 1927 Ndërruar jetë në vitin 2010 Tefta DANUSHI 1925 Ali ELTARI 1940 Edlira ELTARI 1991 Elmaz ELTARI 1935 Florjan ELTARI 1994 Mukadez ELTARI 1956 Saide ELTARI 1944 Tajar ELTARI 1938 Shpresa MEZINI 1931	Puto Sokol Tiranë	12.10.2012 Më 10.12.2024 Qeveria deklaroi që i qëndronte deklaratës së saj të njëanshme të vitit 2012.	6.1.2025	5.000, bashkërisht për palën kërkuarë

Trashëgimtar/ët në kërkesën nr. 33547/08

Trashëgimtar	Trashëgimtar
Rrapo DANUSHI Ndërruar jetë në vitin 2021	Jürgen ZENAJ Lindur më 1974-n
Fejzie DANUSHI Ndërruar jetë në vitin 2010	

² Plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet palës kërkuarë.



VENDIM
Nr. 1, datë 30.4.2025

**PËR PËRCAKTIMIN E SHTETEVE QË
SIGUROJNË NJË NIVEL TË
MJAFTUESHËM TË MBROJTJES SË TË
DHËNAVE PERSONALE**

Në mbështetje të pikave 2 dhe 3, të nenit 40, germës “gj”, pikës 1, të nenit 82, pikës 1, të nenit 85, dhe pikës 2, të nenit 97, të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim quajtur “ligji”), Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

VENDOSI:

1. Shtetet që sigurojnë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, mbështeten në kriteret si më poshtë:

a) shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, që zbatojnë Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (GDPR), e cila përbën një akt të përbashkët, drejtpërdrejtë të zbatueshëm, që përmban parimet thelbësore dhe rregullat e përpunimit të të dhënave personale;

b) shtetet anëtare të Zonës Ekonomike Evropiane, që në bazë të Marrëveshjes së EEA³-së, zbatojnë Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR);

c) palët e Konventës 108 të Këshillit të Evropës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”, si dhe protokollit të saj shtesë të vitit 1981, të cilat kanë miratuar një ligj për mbrojtjen e të dhënave dhe kanë krijuar një autoritet mbikëqyrës që ushtron funksionin e tij me pavarësi të plotë, duke siguruar mekanizma ligjorë të përshtatshëm, përfshirë trajtimin e ankesave, hetimin dhe garantimin e transparencës në përpunimin e të dhënave personale;

ç) shtetet, ku transferimi i të dhënave personale, mund të kryhet sipas një vendimi përshtatshmërie të Komisionit të Bashkimit Evropian;

d) me vendim të Komisionerit për shtetet ose organizatat ndërkombëtare që plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 40, pika 3, të ligjit.

2. Shtetet që konsiderohen se garantojnë një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale sipas kriterëve më sipër, janë të përcaktuar në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Vendimi nr. 8, datë 31.10.2016, “Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E
INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**
Besnik Dervishi

ANEKS NR. 1
VENDET TË CILAT KANË NIVEL TË
MJAFTUESHËM PËR MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

- Andorra	- Kroaci
- Argjentinë	- Letoni
- Austri	- Lihtenshtajn
- Belgjikë	- Lituani
- Bosnjë dhe Hercegovinë	- Luksemburg
- Bullgari	- Mal i Zi
- Danimarkë	- Maltë
- Estoni	- Maqedoni e Veriut
- Finlandë	- Mbretëri e Bashkuar
- Francë	- Moldavi
- Greqi	- Monako
- Guernsey	- Norvegji
- Gjeorgji	- Poloni
- Gjermani	- Portugali
- Holandë	- Qipro
- Hungari	- Republikë Çeke
- Irlandë	- Rumani
- Islandë	- San Marino
- Ishulli i Manit	- Serbi
- Ishujt Faroe	- Sllovaki
- Itali	- Slloveni
- Izrael	- Spanjë
- Japoni	- Suedi
- Jersey	- Shtetet e Bashkuara të Amerikës ⁵
- Kanada ⁴	- Uruguaj
- Koreja Jugore	- Zelandë e Re
- Kosovë	- Zvicër

³ *European Economic Area (EEA) – Zona Ekonomike Evropiane.*

⁴ Niveli i mjaftueshëm zbatohet vetëm për shoqëritë tregtare sipas vendimit të Komisionit Evropian 2002/2/EC, datë 20 dhjetor 2001.

⁵ Niveli i mjaftueshëm zbatohet vetëm për shoqëritë tregtare që aderojnë në Kuadrin për Mbrojtjen e të Dhënave BE–SHBA sipas vendimit të Komisionit Evropian 2023/1795, datë 10 korrik 2023.



UDHËZIM

Nr. 1, datë 30.4.2025

**PËR MASAT E SIGURISË PËR TË
DHËNAT PERSONALE NË FUSHËN
E ARSIMIT**

1.Në mbështetje të gërmës “d”, të pikës 1, të nenit 82, pikës 1, të nenit 85 dhe pikës 2, të nenit 97, të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim quajtur “ligji”), Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

UDHËZON:

Neni 1

Objekti

Ky udhëzim synon përcaktimin e masave të sigurisë dhe rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e të dhënave personale në fushën e arsimit.

Neni 2

Përkufizime

Termat e përdorur në këtë udhëzim, kanë të njëjtin kuptim me ato të nenit 5, të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 3

Dispozitat e përgjithshme

1. Të dhënat personale në fushën e arsimit, mblihen drejtpërdrejtë nga subjektet e të dhënave ose nga kujdestarët e tyre. Subjektet e të dhënave në fushën e arsimit, konsiderohen nxënësit, studentët dhe të gjithë ata që janë regjistruar në një institucion arsimor. Të dhënat e tyre personale sigurohen nga vetë ata kur janë në moshë madhore, ose kur janë të mitur, nga prindërit apo kujdestarët ligjorë.

2. Subjekti i të dhënave, ka të drejtën të informohet për të dhënat që do të përpunohen⁶. Kontrolluesi duhet t'i sigurojë çdo informacion dhe të zhvillojë çdo komunikim sipas neneve 13–20 të ligjit, për përpunimin e të dhënave të tij në formë

koncize, transparente, të kuptueshme dhe lehtësisht të aksesueshme, duke përdorur gjuhë të qartë dhe të thjeshtë, veçanërisht për sa i takon informacionit që i drejtohet në mënyrë specifike një të mituri.

Neni 4

**Të dhënat personale sensitive në fushën e
arsimit**

1. Të dhënat personale që lidhen me gjendjen shëndetësore, aftësitë ndryshe, kontrolle mjekësore, vizita psikologjike në ambientet e shkollave, trajtohen si të dhëna sensitive⁷, të cilat përpunohen vetëm sipas nenit 9, të ligjit.

2. Për ruajtjen e këtyre të dhënave është i rëndësishëm përcaktimi i vendeve të sigurta ku do të mbahen këto të dhëna, duke siguruar që ato mund të aksesohen vetëm nga persona të autorizuar. Në rastet e përpunimit të automatizuar të të dhënave, printimi dhe skanimi duhet të realizohen vetëm me pajisje me përdorim specifik dhe jo të zakonshme. Kopjimi i të dhënave duhet të kryhet vetëm kur është i domosdoshëm. Kur përpunimi kryhet nëpërmjet transferimit të të dhënave, ato duhet të jenë të enkriptuara.

3. Profesionistët e angazhuar në fushat e përmendura në pikën 1 të këtij neni, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre të punës, nuk duhet të përhapin informacionet me të cilat bien në kontakt nga raportet ose dosjet individuale të nxënësit/studentët e tjerë, mësuesit apo palë të treta, përveç rastit kur ky proces përpunimi kryhet për shkak të interesit jetik të subjektit të të dhënave, në përputhje me gërmën “c”, të nenit 9, të ligjit.

Neni 5

**Përpunimi i të dhënave personale në fushën
e arsimit**

1. Të dhënat e përpunuara në përputhje me parashikimet e nenit 6 të ligjit, mund të ruhen për aq kohë sa është e nevojshme për qëllimet për të cilat ato janë mbledhur. Nëse të dhënat e ruajtura nuk janë më të nevojshme, ato duhet të fshihen, të anonimizohen ose të shkatërrohen duke zbatuar masat e duhura të sigurisë.

⁶ Në zbatim të nenit 13, të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

⁷ Pika 28, e nenit 5, të ligjit citon: “Të dhëna sensitive” janë kategori të veçanta të të dhënave personale, që përfshijnë origjinën racore ose etnike,

mendimet politike, besimin fetar ose pikëpamjet filozofike, anëtarësimin në sindikata, të dhënat gjenetike, të dhënat biometrike, të dhënat për shëndetin, jetën ose orientimin seksual të një personi”.



2. Etika ka një rol thelbësor gjatë përpunimit të të dhënave. Respektimi i parimit të integritetit dhe konfidencialitetit sipas pikës 6, të nenit 6 të ligjit, është i rëndësishëm të zbatohet sa herë që përpunohen të dhëna personale. Kontrolluesit, përpunuesit dhe personeli që vihen në dijeni të përmbajtjes së të dhënave personale gjatë kryerjes së aktiviteteve të tyre profesionale janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin edhe pas mbarimit të funksionit të tyre.

Neni 6 Masat e sigurisë

1. Është detyrë e kontrolluesit që, duke marrë parasysh zhvillimet teknologjike, kostot e zbatimit dhe natyrën, fushën e zbatimit, kontekstin dhe qëllimet e përpunimit, si dhe mundësinë e shfaqjes e përshkallëzimit të rrezikut për të drejtat dhe liritë e personave fizikë, të zbatojë masat e duhura teknike dhe organizative për të siguruar një nivel sigurie të përshtatshëm ndaj rrezikut.

2. Këto masa konsistojnë ndër të tjera në:

a) pseudonimizimin dhe enkriptimin e të dhënave personale;

b) aftësinë për të garantuar konfidencialitetin, integritetin, disponueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e sistemeve dhe të shërbimeve të përpunimit;

c) aftësinë për të rivendosur disponueshmërinë dhe aksesin në të dhënat personale brenda një kohe të arsyeshme në rast incidenti fizik ose teknik;

ç) një proces për testimin, shqyrtimin dhe vlerësimin e rregullt të efikasitetit të masave teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë e përpunimit;

d) instalimin dhe përditësimin e antivirusit dhe *firewall*-t që mbrojnë kompjuterët;

dh) përditësimin e sistemit operativ dhe shkarkimin e versioneve më të fundit të aplikacioneve;

e) lejimin e stafit të ketë akses vetëm në materialet që janë të nevojshme për të realizuar detyrat e tyre;

ë) kujdesin në përdorimin e fjalëkalimeve.

Në vlerësimin e nivelit të përshtatshëm të sigurisë merren parasysh rreziqet që shkaktohen nga përpunimi, veçanërisht nga shkatërrimi aksidental ose i paligjshëm, humbja, ndryshimi, përhapja e paautorizuar ose aksesit në të dhënat personale të

transmetuara, të ruajtura ose të përpunuara në çfarëdolloj mënyre.

3. Ndërgjegjësimi është shumë i rëndësishëm në funksion të mbrojtjes së të dhënave personale. Kjo arrihet duke informuar nxënësit, studentët dhe prindërit në mënyrë periodike nëpërmjet zhvillimit të trajnimeve mbi këtë temë, duke ftuar edhe profesionistë në fushën e teknologjisë së informacionit.

4. Ngjarjet e cenimit të sigurisë, mund të sjellin pasoja shumë serioze për subjektin e të dhënave personale. Në rast cenimi të të dhënave personale, kontrolluesi njofton Komisionerin sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 72 (shtatëdhjetë e dy) orë pas marrjes dijeni për cenimin. Në rast se njoftimi nuk kryhet brenda këtyre afateve, kontrolluesi i parashtron Komisionerit arsyet që kanë shkaktuar vonesën e njoftimit.

5. Njoftimi për Komisionerin, sipas pikës 1, të këtij neni, duhet që të paktën:

a) të përshkruajë natyrën e cenimit të të dhënave personale, duke përfshirë, kur është e mundur, kategoritë dhe numrin e përafërt të subjekteve të të dhënave, si dhe kategoritë dhe numrin e përafërt të llogarive të të dhënave personale të prekura;

b) të komunikojë emrin dhe të dhënat e kontaktit të nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave ose të pikës tjetër të kontaktit;

c) të përshkruajë pasojat e mundshme të cenimit të të dhënave personale;

d) të përshkruajë masat e marra ose të propozuara për t'u marrë nga kontrolluesi për të trajtuar cenimin e të dhënave personale, duke përfshirë, sipas rastit, masat për të zbutur efektet e mundshme negative të tij.

6. Stafi duhet të jetë i përgjegjshëm duke vepruar në mënyrë të menjëhershme dhe të përshtatshme gjatë përpunimit të të dhënave. Për këtë arsye, është e rëndësishme të rishikohen politikat, praktikat, masat e ndërmarra, si dhe procedurat e ndjekura për të siguruar që ato përputhen plotësisht me parimet e mbrojtjes së të dhënave.

Neni 7 Transferimi i të dhënave personale në fushën e arsimit

1. Transferimi i të dhënave personale të nxënësve, studentëve, prindërve ose kujdestarëve të tyre, si dhe i stafit mësimor, administrativ të



shkollave dhe organeve përgjegjëse, lejohet vetëm nëse:

a) subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin⁸, që shërben si provë e shfaqjes së vullnetit të qartë, të plotë e të lirë, çka nënkupton që subjekti i të dhënave është informuar për arsyen e përpunimit dhe shpreh pëlqimin për përpunimin e të dhënave personale që i përkasin atij/asaj për një ose më shumë qëllime të caktuara;

b) është e nevojshme për përmbushjen dhe realizimin e detyrave që përcakton legjislacioni në fushën e arsimit. Të dhënat nuk përpunohen për një qëllim tjetër nga ai⁹ fillestar i përcaktuar në momentin e mbledhjes. Nëse të dhënat duhet të transferohen për një qëllim të ndryshëm nga ai fillestar, subjekti i të dhënave duhet të japë përsëri pëlqimin për këtë qëllim të ri.

2. Nëse të dhënat personale do të transferohen për një qëllim të ndryshëm, kontrolluesi duhet të sigurohet që edhe qëllimi i ri të jetë në përputhje me të gjitha parimet e mbrojtjes së të dhënave dhe dispozitat e ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, si dhe të sigurojë që subjekti i të dhënave të ketë dhënë përsëri pëlqimin për këtë qëllim të ri.

3. Çdo transferim duhet të dokumentohet në përputhje me nenin 27, të ligjit.

Neni 8

Dispozita përfundimtare

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen të gjithë kontrolluesit/përpunuesit publikë dhe privatë në territorin e Republikës së Shqipërisë, që ushtrojnë veprimtari në fushën e arsimit.

2. Moszbatimi i kërkesave të këtij udhëzimi përbën shkelje të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe dënohet në përputhje me nenin 94, të këtij ligji.

3. Udhëzimi nr. 4, datë 16.3.2010, “Për marrjen e masave të sigurisë së të dhënave personale në veprimtarinë e fushës së arsimit” dhe udhëzimi nr. 7, datë 9.6.2010, “Për përpunimin e të dhënave

personale në institucionet e arsimit të lartë”, shfuqizohen.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E
INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
Besnik Dervishi

UDHËZIM

Nr. 2, datë 30.4.2025

PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE SHËNDETËSORE

Në mbështetje të germës “d”, të pikës 1, të nenit 82, pikës 1, të nenit 85 dhe pikës 2, të nenit 97, të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim quajtur “ligji”), Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

UDHËZON:

Neni 1

Dispozita të përgjithshme

1. Ky udhëzim ka për qëllim të rregullojë përpunimin e të dhënave personale dhe sensitive që lidhen me fushën e shëndetësisë, duke synuar garantimin e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të çdo individ, veçanërisht, të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale dhe një jetë private sipas ligjit.

2. Zbatimi i tij shtrihet për të gjithë personat fizik dhe juridik të cilët veprojnë në sistemin e kujdesit shëndetësor, publik ose privat, organet e tjera përgjegjëse për mbikëqyrjen ose kontrollin e kujdesit shëndetësor, si dhe përpunuesit e të dhënave që veprojnë për llogari të tyre.

3. Ky udhëzim zbatohet, gjithashtu, edhe për shkëmbimin dhe komunikimin e të dhënave që

⁸ Pika 14, e nenit 5, të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, citon: “Pëlqim” është çdo element tregues i vullnetit të subjektit të të dhënave, i dhënë lirisht, i informuar dhe i qartë, nëpërmjet të cilit ai, me anë të një deklarate ose me çdo lloj shfaqjeje tjetër të padyshimitë pohuese të vullnetit, shpreh dakordësinë për përpunimin e të dhënave personale, që lidhen me të për një ose më shumë qëllime specifike”.

⁹ Pika 17, e nenit 5, të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, citon: “Përpunim i mëtejshëm” është përpunimi i të dhënave për një qëllim tjetër, të ndryshëm nga ai fillestar, i përcaktuar në momentin e mbledhjes së të dhënave, duke përfshirë transferimin ose vënien në dispozicion të të dhënave për këtë qëllim të ri”.



lidhen me shëndetin me anë të pajisjeve digjitale, për aq sa nuk rregullohet nga legjislacioni i posaçëm.

4. Në këtë udhëzim, shprehjet e mëposhtme përkufizohen si më poshtë:

a) “profesionistët e shëndetësisë”, janë të gjithë profesionistët e njohur si të tillë nga legjislacioni i brendshëm në sektorët e kujdesit shëndetësor, të cilët i nënshtrohen detyrimit të konfidencialitetit dhe që janë të përfshirë në ofrimin e kujdesit shëndetësor;

b) terma të tjerë, të përdorur në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim si në ligj.

Neni 2

Përpunimi i të dhënave shëndetësore

1. Çdo kontrollues që përpunon të dhëna që lidhen me shëndetin, të cilat kategorizohen si sensitive, duhet të respektojë dhe zbatojë parimet e parashikuara në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Kontrolluesit e të dhënave dhe përpunuesit që veprojnë nën përgjegjësinë e tyre, duhet të marrin të gjitha masat e duhura për të përmbushur detyrimet e tyre në lidhje me mbrojtjen e të dhënave dhe duhet të jenë në gjendje të provojnë, në veçanti ndaj autoritetit kompetent mbikëqyrës, që përpunimi është në përputhje me këto detyrime.

3. Të dhënat që lidhen me shëndetin mund të përpunohen vetëm kur parashikohet shprehimisht nga legjislacioni i posaçëm i kontrolluesit/përpunuesit, kur përpunimi është i nevojshëm, për:

a) qëllimet mjekësore parandaluese, qëllimet e diagnostikimit, administrimin e kujdesit ose trajtimit, menaxhimin e shërbimeve shëndetësore nga profesionistët e shëndetësisë dhe ato të sektorëve të kujdesit shëndetësor apo mirëqenies sociale;

b) qëllimet e mbrojtjes së shëndetit publik, të tilla si mbrojtja nga rreziqet shëndetësore, veprimet humanitare ose për të siguruar një standard të lartë të cilësisë dhe sigurisë për trajtimin mjekësor;

c) qëllimi i mbrojtjes së interesave jetikë të subjektit të të dhënave ose të një personi tjetër;

ç) arsyet që kanë të bëjnë me detyrimet e kontrolluesve dhe ushtrimin e të drejtave të tyre ose ato të subjekteve të të dhënave lidhur me punësimin dhe mbrojtjen sociale, në përputhje me ligjin;

d) përpunimin për qëllime arkivimi në interes të publikut ose për qëllimet e kërkimit shkencor

historik, apo statistikor, sipas kushteve të përcaktuara me ligj;

dh) mbrojtjen e interesit publik në bazë të ligjit. Në këtë rast, masat në fjalë duhet të jenë proporcionale me qëllimin e ndjekur, të respektojnë parimet e së drejtës për mbrojtjen e të dhënave dhe sigurojnë masa të përshtatshme dhe specifike për të mbrojtur të drejtat themelore dhe interesat e subjektit të të dhënave;

e) kur subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin, me përjashtim të rasteve kur legjislacioni në fuqi ndalon përpunimin e këtyre të dhënave edhe mbi bazë pëlqimi;

ë) kur përpunimi është i nevojshëm për zbatimin e një kontrate të lidhur nga subjekti i të dhënave, ose në emër të tij, me një profesionist të shëndetësisë, sipas kushteve të përcaktuara me ligj, duke përfshirë detyrimin e ruajtjes së sekretit profesional;

f) kur të dhënat që lidhen me shëndetin, bëhen publike me pëlqimin e vetë subjektit të të dhënave.

4. Në rastet e pacientëve të mitur, të cilët nuk janë në gjendje për të dhënë pëlqimin, pëlqimi jepet nga përfaqësuesit ligjorë (*prindi apo kujdestari ligjor i të miturit*).

5. Për të dhënat që lidhen me shëndetin e fetusit, si të dhënat që rezultojnë nga diagnoza prenatale dhe/ose nga identifikimi i karakteristikave gjenetike të tij, duhet të zbatohen garancitë e mësipërme, për aq sa është e mundur.

Neni 3

Të dhënat gjenetike

1. Të dhënat gjenetike, janë të dhëna sensitive dhe përpunohen vetëm në rastet e parashikuara në nenin 9 të ligjit.

2. Të dhënat gjenetike duhet të mbledhen vetëm kur ekzistojnë masat e përshtatshme të mbrojtjes, kur është parashikuar me ligj dhe/ose në bazë të pëlqimit të shprehur nga subjekti i të dhënave.

3. Të dhënat gjenetike të përpunuara me qëllim parandalues, diagnostikues, trajtimin e subjektit të të dhënave apo të një anëtarit të familjes biologjike të tij, ose për kërkime shkencore, duhet të përdoren vetëm për këto qëllime.

4. Të dhënat gjenetike të mbledhura gjatë një procesi gjyqësor, duhet të përpunohen vetëm kur nuk ka mjete alternative për administrimin e provave, të nevojshme për të parandaluar një rrezik real dhe të menjëhershëm, apo për procedimin e një



vepre penale të caktuar, sipas garancive procedurale të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.

5. Subjekti i të dhënave ka të drejtë të njihet me çdo informacion në lidhje me të dhënat e tij gjenetike. Kontrolluesi duhet t'i garantojë subjektit të të dhënave të drejtën e aksesit në formën dhe mënyrën më të përshtatshme. Kufizimi i kësaj të drejte mund të zbatohet vetëm në rastet e parashikuara shprehimisht në ligj.

6. Çdo kontrollues që përpunon të dhëna që lidhen me shëndetin, të cilat kategorizohen si sensitive, duhet të respektojë dhe zbatojë parimet e parashikuara në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

7. Kontrolluesit e të dhënave dhe përpunuesit që veprojnë nën përgjegjësinë e tyre, duhet të marrin të gjitha masat e duhura për të përmbushur detyrimet e tyre në lidhje me mbrojtjen e të dhënave dhe duhet të jenë në gjendje të provojnë, në veçanti ndaj autoritetit kompetent mbikëqyrës, që përpunimi është në përputhje me këto detyrime.

Neni 4

Përhapja e të dhënave shëndetësore

1. Kur të dhënat që lidhen me shëndetin përhapen nga profesionistë të ndryshëm të shëndetit, për qëllime të ofrimit dhe administrimit të kujdesit shëndetësor për një individ, subjekti i të dhënave duhet të informohet paraprakisht, përveçse kur kjo është e pamundur për shkak të nevojës dhe urgjencës.

2. Kur përhapja bazohet në pëlqimin e subjektit të të dhënave, ky pëlqim mund të tërhiqet në çdo kohë. Kur përhapja është e përcaktuar me ligj, subjekti i të dhënave mund të kundërshtojë përhapjen e të dhënave të tij shëndetësore, sipas parashikimeve të ligjit.

3. Profesionistët e shëndetësisë në sektorët të ndryshëm të kujdesit shëndetësor dhe të mirëqenies sociale, duhet t'i nënshtrohen detyrimeve për konfidencialitetin e të dhënave.

4. Rregullat për përpunimin e të dhënave zbatohen edhe për dosjet mjekësore elektronike dhe komunikimin me adresat elektronike që mundësojnë përhapjen dhe shkëmbimin e të dhënave që lidhen me shëndetin. Në çdo rast duhet zgjedhur rruga më e përshtatshme dhe e sigurt, si dhe të mos përdoren adresa personale apo aplikacione (*si WhatsApp*) për këtë përhapje.

5. Në shkëmbimin dhe përhapjen e të dhënave që lidhen me shëndetin, duhet të miratohen masat fizike, teknike dhe administrative të sigurisë, si edhe masat e nevojshme për të garantuar konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e të dhënave që lidhen me shëndetin.

6. Të dhënat që lidhen me shëndetin mund të komunikohen te kontrolluesit/përpunuesit që janë të autorizuar me ligj për të pasur akses në këto të dhëna ose kur jep pëlqimin vetë subjekti i të dhënave për këtë përhapje.

7. Shoqëritë e sigurimit janë të autorizuar për të pasur akses në të dhënat që lidhen me shëndetin, deri në nivelin që parashikohet nga ligji i posaçëm ose deri në nivelin që subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin, duke zbatuar masa mbrojtëse të përshtatshme në përputhje me ligjin dhe parimet e këtij udhëzimi.

8. Punëmarrësit nuk mund të cilësohen si marrës të autorizuar për të pasur akses në të dhënat që lidhen me shëndetin e individëve, përveç sipas kushteve që parashikohen nga ky udhëzim për përpunimin e të dhënave personale në kontekstin e punësimit.

Neni 5

Arkivimi dhe afati i ruajtjes së të dhënave shëndetësore

1. Të dhënat që lidhen me shëndetin nuk duhet të ruhen në atë formë që lejon identifikimin e subjekteve të të dhënave për më shumë se sa është e nevojshme, apo në tejkallim të qëllimeve për të cilat përpunohen, nëse nuk përdoren për qëllime arkivimi në interes të publikut, qëllime shkencore, historike apo statistikore.

2. Dispozitat e masave organizative të brendshme për ruajtjen, përpunimin dhe sigurinë e të dhënave, duhet të rezultojnë në masa teknike dhe organizative bashkëkohore, të rishikuara rregullisht, në mënyrë që të mbrohen të dhënat personale që lidhen me shëndetin nga çdo shkatërrim i paligjshëm ose aksidental, çdo humbje apo ndryshim si dhe për t'i mbrojtur ato nga çdo akses i paautorizuar.

3. Arkivimi manual ose elektronik i të dhënave shëndetësore mund të kryhet nga vetë kontrolluesi publik ose privat, ose mund të delegohet te përpunues të tjerë në përputhje me procedurat ligjore lidhur me delegimin e përpunimit.



4. Afati i ruajtjes së të dhënave shëndetësore, caktohet në përputhje me legjislacionin specifik, në zbatim të të cilit ushtron veprimtarinë kontrolluesi/përpunuesi si dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

5. Të dhënat e përpunuara në mënyrë manuale ose automatike pas përfundimit të afatit, shkatërrohen ose anonimizohen në mënyrë që individët të mos identifikohen ose të bëhen të identifikueshëm.

Neni 6

Të drejtat e subjektit të të dhënave

1. Subjekti i të dhënave ka të drejtë të dijë nëse të dhënat personale të tij po përpunohen, të marrë pa vonesë informacion në një formë të kuptueshme rreth të dhënave si dhe të ketë akses në informacionin sipas parashikimeve të ligjit.

2. Subjekti i të dhënave ka të drejtë të kërkojë korrigjimin ose fshirjen e të dhënave, kur vihet në dijeni se të dhënat rreth tij nuk janë të rregullta, të vërteta të plota ose janë përpunuar dhe mbledhur në kundërshtim me ligjin.

3. Nëse kërkesa për të korrigjuar ose fshirë të dhënat refuzohet, subjektit të të dhënave duhet t'i jepen arsyet ligjore për këtë qëllim. Në rast refuzimi të paargumentuar, apo mosveprimi nga kontrolluesi, subjekti i të dhënave ka të drejtë të ushtrojë ankim pranë Komisionerit sipas rregullave të parashikuara në ligj.

Neni 7

Detyrimet e kontrolluesit dhe përpunuesit

1. Kontrolluesi duhet të informojë subjektet e të dhënave për përpunimin e të dhënave të tyre që lidhen me shëndetin sipas parashikimeve të ligjit.

2. Ky informacion duhet t'i jepet subjektit të të dhënave përpara mbledhjes së të dhënave ose në komunikimin më të parë me të. Informacioni duhet të jetë i kuptueshëm dhe lehtësisht i aksesueshëm, në gjuhë të qartë dhe të përshtatshme, për t'i lejuar subjektit të të dhënave që të kuptojë plotësisht përpunimin e parashikuar. Në veçanti, kur subjekti i të dhënave është i paafte për të marrë informacionin, ai duhet t'i jepet kujdestarit ligjor.

3. Kontrolluesit nuk i kërkohet të informojë subjektin e të dhënave kur përpunimi është parashikuar shprehimisht me ligj.

4. Kur përpunimi kryhet me mjete automatike, kontrolluesi/përpunuesi duhet t'i garantojë subjektit të të dhënave, sipas kushteve të përcaktuara me ligj, transmetimin në një format të strukturuar, interaktiv dhe të lexueshëm të të dhënave personale në rastin e transferimit të tyre në një kontrollues tjetër.

Neni 8

Konfidencialiteti dhe siguria e të dhënave shëndetësore

1. Përpunimi i të dhënave shëndetësore është i ligjshëm vetëm kur kryhet nga profesionistët e shëndetësisë që kanë detyrimin për të ruajtur sekretin profesional dhe konfidencialitetin e të dhënave, ose nga persona të tjerë që janë subjekte të një detyrimi të tillë.

2. Kontrolluesit duhet të marrin masat e nevojshme të sigurisë në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen së të dhënave personale. Këto masa duhet të rishikohen në mënyrë periodike.

3. Për të siguruar konfidencialitetin, integritetin, saktësinë e të dhënave të përpunuara, sigurinë dhe mbrojtjen e pacientëve, duhet të merren masa të përshtatshme:

a) për të parandaluar aksesin e çdo personi të paaautorizuar në instalimet e përdorura për përpunimin e të dhënave personale (kontrolli i hyrjes në instalime);

b) për të parandaluar hyrjen e paaautorizuar në të dhënat e përpunuara në sistemin e informacionit, si dhe çdo konsultim, modifikim ose fshirje të paaautorizuar të të dhënave personale të përpunuara;

c) për të parandaluar përdorimin e sistemeve të automatizuara të përpunimit të të dhënave nga persona të paaautorizuar me anë të pajisjeve të transmetimit të të dhënave (kontrolli i përdorimit);

ç) për të garantuar mundësinë e kontrollit dhe konstatimit për individët ose subjektet e të cilët mund të komunikohen të dhënat shëndetësore me pajisjet e transmetimit të të dhënave (kontrolli i komunikimit);

d) për të garantuar mundësinë e kontrollit se kush ka pasur qasje në sistem dhe cilat të dhëna shëndetësore janë futur në sistemin e informacionit, kur dhe nga kush (kontrolli i hedhjes së të dhënave);

dh) për të parandaluar leximin, kopjimin, ndryshimin ose fshirjen e paaautorizuar të të dhënave shëndetësore gjatë komunikimit të të dhënave



personale dhe transmetimit të bazës së të dhënave (kontrolli i transmetimit);

e) për të mbrojtur të dhënat duke bërë kopje të sigurisë.

4. Kontrolluesit/përpunuesit publik dhe privat të dokumentacionit mjekësor, duhet të hartojnë rregullore të brendshme që reflekton parimet e përcaktuara në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe në këtë udhëzim.

Neni 9

Kërkimi shkencor

1. Përpunimi i të dhënave shëndetësore për qëllimet e kërkimit shkencor duhet t'i nënshtrohet masave të përshtatshme të mbrojtjes të parashikuara me ligj dhe në këtë udhëzim, duke garantuar të drejtat dhe liritë themelore të subjektit të të dhënave.

2. Nevoja e përpunimit të të dhënave shëndetësore për kërkimin shkencor duhet të vlerësohet në pikëpamjen e qëllimeve kërkimore, rreziqeve ndaj subjektit të të dhënave, si dhe për sa i përket përpunimit të të dhënave gjenetike, në kuadër të rrezikut për familjen biologjike.

3. Të dhënat shëndetësore, në parim, duhet të përpunohen vetëm në një projekt kërkimi shkencor, nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin në përputhje me këtë udhëzim, me përjashtim të rasteve të parashikuara ndryshe me ligj.

4. Të dhënat duhet të anonimizohen kur qëllimet e kërkimit shkencor e lejojnë. Kur qëllimet e kërkimit nuk e lejojnë këtë, duhet të zbatohet pseudonimizimi i të dhënave në fazën e ndarjes së identifikimit, për të mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore të subjektit të të dhënave.

5. Kur subjekti i të dhënave tërhiqet nga një projekt i kërkimit shkencor, të dhënat që lidhen me shëndetin, të përpunuara në kuadër të atij kërkimi, duhet të shkatërrohen ose anonimizohen në një mënyrë që nuk kompromenton vlefshmërinë shkencore të kërkimit, duke informuar subjektin e të dhënave.

6. Të dhënat personale të përdorura për kërkim shkencor nuk duhet të publikohen në një formë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, përjashtuar rastin kur subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin dhe/ose kur parashikohet shprehimisht nga ligji.

Neni 10

Përpunimi i të dhënave nëpërmjet pajisjeve elektronike të lëvizshme

1. Për të dhënat që mbledhen nga pajisje elektronike të lëvizshme dhe që mund të zbulohet informacion mbi gjendjen shëndetësore fizike dhe mendore të subjektit të të dhënave, zbatohen të njëjtat parime dhe garanci për përpunimin e të dhënave të tjera që lidhen me shëndetin, të parashikuara në këtë udhëzim.

2. Çdo përdorim i pajisjeve elektronike të lëvizshme duhet të shoqërohet nga masa të përshtatshme sigurie që garantojnë verifikimin e personit përkatës dhe enkriptimin gjatë transmetimit të të dhënave.

Neni 11

Transferimi ndërkombëtar i të dhënave shëndetësore

Transferimi ndërkombëtar i të dhënave shëndetësore kryhet në përputhje me dispozitat 39–42 të ligjit, si dhe aktet nënligjore të miratuara nga Komisioneri.

Neni 12

Dispozita të fundit

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen të gjithë kontrolluesit/përpunuesit publik dhe privat në territorin e Republikës së Shqipërisë, që ushtrojnë veprimtari në fushën e shëndetësisë.

2. Moszbatimi i këtij udhëzimi sanksionohet në përputhje me parashikimet e nenit 94 të ligjit.

3. Udhëzimi nr. 49, datë 2.3.2020, “Për mbrojtjen e të dhënave personale shëndetësore”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E
INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
Besnik Dervishi



UDHËZIM

Nr. 3, datë 30.4.2025

**PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE
PERSONALE NGA SISTEMET
E VIDEOSURVEJIMIT**

Në mbështetje të germës “d”, të pikës 1, të nenit 82, pikës 1, të nenit 85 dhe pikës 2, të nenit 97, të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim quajtur “ligji”), Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

UDHËZON:

Neni 1

Përpunimi i të dhënave personale

1. Të dhënat e ruajtura në sistemin e videosurvejimit si imazhet apo tinguj¹⁰ (në vijim quajtur “sistem CCTV”), janë të dhëna personale, me kusht që një individ të mund të identifikohet drejtpërdrejt ose tërthorazi bazuar në këto regjistrime. Një individ është i identifikueshëm, nëse imazhi ose tingulli, që regjistrohet në këto sisteme, zbulon karakteristika dalluese të tij, si: fytyra, tiparet fizike, të dhënat e zërit etj., duke bërë të mundur identifikimin e plotë kur krahasohen me të dhëna të tjera të disponueshme.

2. Instalimi dhe përdorimi i sistemeve CCTV, që përpunojnë të dhënat personale, duhet të jetë në përputhje me të drejtat themelore të njeriut, si e drejta për jetën private, familjare dhe e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale.¹¹

3. Regjistrimet e ruajtura në sistemin CCTV, që përmbajnë të dhëna personale, nuk mund të shpërndahen, përveç rasteve kur parashikohet me ligj.

Neni 2

**Kushtet paraprake për mbikëqyrjen e
ligjshme me kamera**

1. Përpunimi i të dhënave personale, përmes sistemit të CCTV përbën një ndërhyrje serioze në

jetën private të individit. Kontrolluesi mund të përpunojë këto të dhëna vetëm kur legjitimohet sipas nenit 7, të ligjit.

2. Kontrolluesi i të dhënave duhet të sigurojë marrjen e pëlqimit të subjektit të të dhënave, por praktikisht kjo është e mundshme vetëm në raste shumë të kufizuara, atëherë kur identifikimi i një grupi personash brenda zonës së kamerës bëhet në mënyrë të qartë. Në shumicën e rasteve, kontrolluesi e ka të pamundur identifikimin paraprak të individëve që do të kalojnë në zonën e survejuar, për të siguruar më parë “pëlqimin” e tyre. Në këtë rast, Kontrolluesi legjitimohet të vendosë sisteme CCTV, nëse ky përpunim është i nevojshëm për përmbushjen e një detyrimi ligjor¹² apo të interesave të ligjshëm¹³ të tij. Në çdo rast duhet të garantojë që nuk ka mënyrë tjetër më pak ndërhyrëse në jetën e subjekteve të të dhënave për përmbushjen e qëllimit.

3. Interesi i ligjshëm në funksionimin e një sistemi CCTV, nënkupton që:

a) kontrolluesi ka të drejtë të vendosë se kush lejohet të hyjë dhe të qëndrojë brenda zonës nën vëzhgim (*e drejta mbi ambientin*);

b) përdorimi i një sistemi CCTV duhet të justifikohet nga një nevojë e veçantë për të mbrojtur të drejtat e kontrolluesit ose të personave të tretë, si rreziku nga vjedhja ose kërcënimi për sigurinë fizike ose mendore të personave që qëndrojnë brenda zonës së mbikëqyrur;

c) qëllimi i regjistrimit duhet të specifikohet qartë dhe në përputhje me interesat ligjore të kontrolluesit (*p.sh. mbrojtja e pronës kundër vjedhjes*);

ç) përpunimi i të dhënave me anë të sistemit CCTV mund të lejohet vetëm nëse qëllimi për të cilin është instaluar ky sistem, nuk mund të arrihet në ndonjë mënyrë tjetër;

d) ndalohet instalimi i një sistemi CCTV, në ambiente që përdoren ekskluzivisht për qëllime private, si: tualete, dushe, dhoma zhveshje etj.

4. Meqenëse përpunimi i të dhënave kryhet për përmbushjen e interesave të ligjshëm të kontrolluesit, është thelbësore që të merren parasysh interesat e subjekteve të të dhënave, në mënyrë që të dhënat e sistemit CCTV të mos jenë të aksesueshme nga persona të paautorizuar. Në këto kushte:

¹⁰ Kur sistemi CCTV përfshin edhe këtë element.

¹¹ Këto të drejta janë të parashikuara në nenin 8, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe në ligj.

¹² Germa “c”, e pikës 1, të nenit 7, të ligjit, nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

¹³ Germa “dh”, e pikës 1, të nenit 7, të ligjit, nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.



a) të dhënat duhet të ruhen për një afat sa më të shkurtër të jetë e mundur;

b) rrethi i personave që kanë akses në të dhënat e regjistruara duhet të kufizohet e të jetë sa më i ngushtë të jetë e mundur;

c) çdo akses i marrë në të dhënat e regjistruara duhet të dokumentohen, për qëllime të një kontrolli të mundshëm të mëvonshëm. Të dhënat e regjistruara për parandalimin e rrezikut, si arsyeja e instalimit të sistemit CCTV, nuk do të përdoren për qëllime të tjera, përveç rasteve që parashikohen me ligj, p.sh. për interesa të rëndësishme publike si lufta kundër krimit.

5. Përpara fillimit të përpunimit të të dhënave personale me anë të sistemit CCTV, duhet të merret dhe të dokumentohet me një akt të brendshëm nga organi vendimmarrës i kontrolluesit, duke përcaktuar pikat e mëposhtme:

a) llojin, specifikimet e kamerave dhe vendosjen e tyre në përputhje me qëllimin për të cilin do të përdoren. Pozicioni i kamerave nuk duhet të jetë në një mënyrë, nga e cila përftohen imazhe nga mjedise që nuk përputhen me qëllimin e mbikëqyrjes;

b) zonat e sakta që do të jenë nën mbikëqyrje; p.sh.: ndalohet monitorimi dhe regjistrimi i imazheve në ambiente private;

c) ndalohet mbikëqyrja dhe transmetimi në kohë reale i imazheve të regjistruara nga sistemi CCTV, nëpërmjet internetit ose shërbimeve të komunikimit elektronik, ku personat mund të identifikohen lehtë.

Neni 3 Afati i ruajtjes

1. Afati i ruajtjes së të dhënave të regjistruara, nuk duhet të kalojë periudhën e nevojshme, për përmbushjen e qëllimit, për të cilin janë regjistruar këto të dhëna.

2. Në përgjithësi të dhënat mund të mbahen:

a) për një periudhë prej 72 orësh¹⁴;

b) për një periudhë më të gjatë, nëse mjediset e kontrolluara nuk janë nën mbikëqyrje të vazhdueshme, megjithatë, jo më shumë se 30 ditë¹⁵;

¹⁴ Rastet kur zbatohet ky afat kanë të bëjnë me sistemet e mbikëqyrja në mënyrë të vazhdueshme nga një person, si për shembull, në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale apo kur një punonjës sigurie i kontraktuar për këtë qëllim ushtron mbikëqyrjen e ekranit përkatës.

c) për periudha më të gjata kur parashikohet me akt normativ/rregullator të posaçëm.

3. Pas përfundimit të periudhës së ligjshme të ruajtjes së regjistrimeve, nga kontrolluesi duhet të ndërmerren masa për fshirjen e këtyre të dhënave. Nëse, në rast të një incidenti sigurie, të dhënat e sistemit CCTV duhet t'u vihen në dispozicion autoriteteve kompetente në kuptim të ligjit.

Neni 4 Mbikëqyrja me kamera në ndërtesat e banimit

1. Sistemet CCTV mund të instalohen në ndërtesat e banimit vetëm me miratimin e të paktën 75% të banorëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit.

2. Mbikëqyrja dhe regjistrimi i imazheve ose tingujve nga sistemet CCTV në ambientet e përbashkëta të ndërtesave me apartamente banimi, lejohet vetëm për qëllime të mbrojtjes së sigurisë së njerëzve dhe pronës.

3. Ndalohet që palëve të treta t'u vihen në dispozicion imazhe të banorëve dhe aktiviteteve të tyre, të regjistruara në ambientet e përbashkëta të banimit me anë të sistemit CCTV, me përjashtim të rasteve kur kjo kërkohet nga autoritetet kompetente.

4. Kontrolluesi është i detyruar të vendosë në ambientet e survejuara me kamera, modelin standard të tabelës informuese për mbikëqyrjen me sistemin CCTV, të miratuar nga Komisioneri, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

Neni 5 Masat e sigurisë

1. Masat e sigurisë duhet të mbrojnë sistemet e regjistrimit dhe pajisjet e transmetimit që ruajnë të dhënat e regjistruara, duke i mbrojtur ato nga aksesit, ndryshimi, shkatërrimi, humbja ose përpunimi i paautorizuar ose aksidental¹⁶.

2. Të dhënat personale duhet të mbahen në mënyrë të sigurt dhe të mos keqpërdoren apo cenohen nga persona të paautorizuar. Siguria nuk

¹⁵ Këto periudha kohore mund të zgjaten për ditët e festave zyrtare.

¹⁶ Sipas neneve 22, 28 dhe 29 të ligjit, nr. 124/2024, "Për mbrojtjen e të dhënave personale".



lidhet vetëm me masat e sigurisë fizike, por ka të bëjë gjithashtu me organizimin e punës në mënyrë të tillë që të minimizohet rreziku, për shembull, duke siguruar që personeli të ketë akses në të dhënat personale vetëm për aq sa është e nevojshme për të kryer veprimtarinë e tyre të punës. Çdo punonjës duhet të trajnohet rregullisht mbi përdorimin e sigurt të të dhënave personale dhe të kuptojë qartë përgjegjësitë dhe kufizimet që ka, në përputhje me kërkesat e ligjit.

3. Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat e autorizuar, të cilët gjatë ushtrimit të detyrës, vihen në dijeni për përmbajtjen e të dhënave të regjistruara nga sistemi CCTV, janë të detyruar ta ruajnë konfidencialitetin edhe pas përfundimit të punës së tyre, për kontrolluesin ose përpunuesin.

Neni 6

Të drejtat e subjekteve të të dhënave

1. Të drejtat e subjekteve të të dhënave janë parashikuar në pjesën II, kapitulli II, i ligjit.

2. Subjektet e të dhënave duhet të informohen qartë për ekzistencën dhe qëllimin e një sistemi CCTV, duke vendosur njoftim në zonën e monitoruar¹⁷. Përgjashtimet janë të pranueshme vetëm kur parashikohen me legjislacion specifik.

3. Të gjitha të drejtat e tjera të subjektit të të dhënave, duhet të garantohen, në përputhje me parashikimet e neneve 13 deri në 20 të ligjit, veçanërisht e drejta për akses, e drejta për të

kundërshtuar dhe e drejta për fshirje.

4. Nëse një subjekt i të dhënave kërkon akses në të dhënat e tij të videosurvejimit, këto të dhëna nuk mund të fshihen nga kontrolluesi pas marrjes së kësaj kërkesë. Në rast se dhënia e aksesit do të përmbushet duke i treguar subjektit të të dhënave materialin e regjistruar, duhet të merren parasysh interesat e mbrojtjes së të dhënave të palëve të treta, duke bërë të mundur anonimizimin e videos duke errësuar imazhin e tyre.

Neni 7

Dispozita përfundimtare

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen të gjithë kontrolluesit/përpunuesit publikë dhe privatë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Moszbatimi i kërkesave të këtij udhëzimi përbën shkelje të ligjit dhe sanksionohet në përputhje me parashikimet e nenit 94, të këtij ligji.

3. Udhëzimi nr. 3, datë 5.3.2010, “Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e videosurvejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E
INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Besnik Dervishi

¹⁷ Neni 13, i ligjit, nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

ZONË E MBIKËQYRUR ME KAMERA



Qëllimi i përpunimit të imazheve tuaja është për të parandaluar cënimin dhe për të garantuar sigurinë e individit, pronës dhe sigurinë publike.

Subjektet e të dhënave personale, mund të ushtrojnë të drejtat e tyre sipas ligjit nr. 124/2024 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” pranë:

(Emri i Kontrolluesit)

(Kontaktet e Kontrolluesit)

Në rast keqpërdorimi të të dhënave personale nëpërmjet sistemit të video survejimit me kamera, subjektet kanë të drejtën të ankohen pranë:

Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Të dhënat tuaja nuk përpunohen për një afat më të gjatë se sa është e nevojshme për përpunimin dhe mbahen me masa sigurie me akses të kufizuar personeli të autorizuar

Nr. i Gjellbër: 0800 20 50

www.idp.al

info@idp.al



UDHËZIM

Nr. 4, datë 30.4.2025

**PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE
PERSONALE DHE MASAT E DUHURA
TË SIGURISË NË MARKETINGUN E
DREJTPËRDREJTË**

Në mbështetje të germës “d”, të pikës 1, të nenit 82, pikës 1, të nenit 85 dhe pikës 2, të nenit 97, të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim quajtur “ligji”), Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

UDHËZON:

Neni 1

Përkufizime

1. “Marketing i drejtpërdrejtë”, është forma e komunikimit me persona drejtpërdrejtë të identifikueshëm, me qëllim promovimin e mallrave ose të shërbimeve, duke përfshirë reklamimin e anëtarësimit në organizata, kërkimin e donacioneve, si dhe aktiviteteve të marketingut të drejtpërdrejtë, që përfshijnë çdo akt përgatitor nga reklamuesi ose nga një palë e tretë për të mundësuar këtë komunikim.

2. Termat e tjerë të përdorur në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim si në ligj.

Neni 2

Qëllimi

1. Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë rregullat që duhen ndjekur nga kontrolluesit apo përpunuesit¹⁸ e të dhënave personale, që gjatë veprimtarisë së tyre realizojnë marketing të drejtpërdrejtë.

2. Kontrolluesit që mbledhin dhe përpunojnë të dhënat personale për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë, duhet të përmbushin të gjitha detyrimet e parashikuara në ligj.

3. Udhëzimi trajton rregullat mbi të cilat duhet të realizohet përpunimi i të dhënave personale për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë, mënyrën si informacioni duhet t’u vihet në dispozicion subjekteve të të dhënave, kufizimet për përpunimin e mëtejshëm, përpunimi i të dhënave të fëmijëve për qëllime marketingu (*si një kategori e veçantë*), masat e duhura të sigurisë dhe detyrimin e kontrolluesve për të lehtësuar ushtrimin e të drejtave të subjektit të të dhënave personale.

Neni 3

**Detyrimet lidhur me përpunimin e të
dhënave personale**

1. Kontrolluesi grumbullon të dhëna për qëllimet e tij të marketingut, nëse i duhen për të përmbushur interesat legjitime të tij¹⁹, me përjashtim të rasteve kur ndaj tyre gëzon prioritet e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale. Në këtë rast, kontrolluesi duhet të sigurojë marrjen e pëlqimit të subjektit të të dhënave.

2. Në rastet kur mbledhen të dhëna sensitive²⁰, kontrolluesi duhet të jetë në gjendje të demonstrojë se subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij/saj të shprehur në mënyrë të qartë dhe specifike, me përjashtim të rastit kur legjislacioni në fuqi ndalon përpunimin e këtyre të dhënave edhe me pëlqimin e tij.

3. I njëjti kusht është i vlefshëm kur kontrolluesi përpunon profilet e interesit të subjekteve të të dhënave që përmbajnë të dhëna sensitive ose penale, me qëllim për të dërguar mesazhe të marketingut “*të personalizuar*”, të cilat janë përshtatur me profilin e supozuar të interesit të subjektit të të dhënave.

4. Kontrolluesi duhet të marrë pëlqimin e subjektit të të dhënave, në rast se siguron të dhëna nga dosjet e klientëve të palëve të treta, duke përpunuar më tej informacionin nëse një person fizik, i identifikuar me emrin, gjininë, grupmoshën dhe adresën e tij/saj, ka qenë klient i palës së tretë.

5. Në rastet kur kontrolluesi për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë të palëve të treta

¹⁸ Përpunimi kryhet nga kontrolluesit/përpunuesit si pjesë e veprimtarisë së tyre ose si përpunim në funksion të objektit parësor të veprimtarisë (*si psh. rasti i call center*).

¹⁹ Germa “dh” e pikës 1, të nenit 7 ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

²⁰ Parashikuar në nenin 9, të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.



mbledh të dhëna që nuk janë të një natyre sensitive apo penale, kjo mund të bazohet në interesin legjitim për aq sa të dhënat janë të mbledhura:

a) nga subjekti i të dhënave - pas informacionit të plotë për transferimet e mundshme të të dhënave;

b) nga burime që mund të aksesohen nga publiku sipas ligjit; ose

c) nga dosjet e klientëve të palëve të treta, me kusht që:

i. këto të dhëna nuk tejkalojnë informacionin se një person fizik, i identifikuar me emrin, gjininë, grup-moshën dhe adresën e tij/saj, ka qenë klient i palës së tretë; dhe se

ii. pala e tretë ka informuar subjektin e të dhënave në momentin e mbledhjes së të dhënave, se të dhënat mund të përdoren për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë të kontrolluesve të tjerë dhe se subjekti i të dhënave nuk ka kundërshtuar, por mund ta bëjë këtë në çdo moment.

6. Në të gjitha rastet e tjera, mbledhja e të dhënave për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë të palëve të treta kërkon pëlqimin e subjektit të të dhënave.

Neni 4

Detyrimet në lidhje me informimin e subjekteve të të dhënave

1. Kontrolluesi duhet të informojë subjektet e të dhënave në zbatim të nenit 13 të ligjit, në rastet kur:

a) të dhënat mbledhen nga vetë subjekti i të dhënave personale²¹, kontrolluesi duhet të japë informacion (përveç rasteve kur subjekti i të dhënave zotëron këtë informacion) lidhur me:

i. identitetin e kontrolluesit;

ii. faktin që përpunimi bëhet për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë dhe se subjekti i të dhënave nuk është në asnjë mënyrë i detyruar të japë këto të dhëna;

iii. bazën ligjore, mbi të cilën është mbështetur kontrolluesi për mbledhjen e të dhënave;

iv. nëse të dhënat do t'u transferohen palëve të treta dhe, nëse po, për identitetin e marrësve dhe për qëllimin dhe bazën ligjore të transferimit;

v. të drejtat e subjekteve të të dhënave²², veçanërisht të drejtën për të kundërshtuar përpunimin e të dhënave për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë. Në këtë rast kontrolluesi nuk duhet të përdorë më tej të dhënat, për qëllime marketingu.

Në rastet kur kontrolluesi nxjerr profilet e interesit të subjekteve të të dhënave, nga të dhënat që ka mbledhur për qëllime marketingu, subjekti i të dhënave duhet të informohet edhe për këtë përpunim të të dhënave.

Informacioni i lartpërmendur duhet të jepet në momentin e mbledhjes së të dhënave, në mënyrë që subjekti i të dhënave personale, të jetë plotësisht i vetëdijshëm për risqet e vënies në dispozicion të të dhënave të tij/saj;

b) në rastet kur të dhënat janë mbledhur nga burime të tjera dhe jo nga subjekti i të dhënave personale²³, informacioni duhet të jepet, për:

i. të gjitha kategoritë e përcaktuara në germën “a”.

ii. burimin(et) nga të cilat janë mbledhur të dhënat. Përveç rastit kur subjekti i të dhënave i mbart këto informacione ose dhënia e informacionit është e pamundur apo përbën një përpjekje jo të arsyeshme dhe kontrolluesi ka marrë masat e duhura për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e ligjshëm të subjektit të të dhënave.

2. Informacioni i përmendur në pikat e mësipërme, duhet të jepet:

a) në kohën e komunikimit të parë me subjektin e të dhënave, në rastin kur kontrolluesi i ka mbledhur të dhënat në mënyrë të qartë, që t'i përcjellë subjektit të të dhënave një mesazh marketingu;

b) në të gjitha rastet e tjera jo më vonë se një muaj pas marrjes së të dhënave;

c) nëse të dhënat do t'i transferohen një pale të tretë, subjekti i të dhënave duhet të informohet, të paktën në momentin kur të dhënat personale transferohen për herë të parë.

²¹ Si për shembull në rastin kur subjekti i nënshtrohet një interviste ose plotësimit të një pyetësori.

²² Sipas neneve 13–20, të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

²³ Si për shembull në rastin kur të dhënat janë marrë nga burime të cilat janë të aksesueshme nga publiku sipas ligjit ose nga palë të treta të autorizuar nga vetë subjekti për këtë qëllim.



Neni 5

Përpunimi i të dhënave për një qëllim tjetër (“përpunim i mëtejshëm”)

1. Në rastin kur të dhënat janë mbledhur për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë, ato nuk do të përpunohen për asnjë qëllim tjetër, përveç rasteve të mëposhtme, kur:

a) ky qëllim është përdorimi për marketing të drejtpërdrejtë dhe

b) subjekti i të dhënave është informuar dhe ka dhënë pëlqimin për përpunimin e mëtejshëm të synuar, përpara se ky proces të fillojë.

2. Koncepti i përpunimit të mëtejshëm, parashikohet në pikën 17, të nenit 5 të ligjit, si një qëllim i ri përpunimi, i cili:

a) zakonisht ndjek një aktivitet në dukje të drejtë me atë të qëllimit fillestar të përpunimit, i përafërt (sipas kohës dhe kontekstit të duhur). Ky përpunim i mëtejshëm duhet të jetë i pritshëm nga ana e subjektit të të dhënave personale, si një qëllim i ri që pason atë fillestar; dhe

b) nuk paraqet rreziqe shtesë të konsiderueshme për subjektin e të dhënave ose kur rreziqe të tilla janë zbutur me sukses dhe janë ndërmarrë masa mbrojtëse shtesë për të drejtat dhe interesat e subjektit të të dhënave personale.

Neni 6

Përpunimi i të dhënave personale të të miturve

1. Në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale, një individ nën moshën 18 vjeç, duhet të konsiderohet si “i mitur” dhe gëzon mbrojtje të veçantë.

2. Në rastin kur kontrolluesit mbledhin të dhëna për të miturit, për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë, duhet t’i kushtojnë vëmendje të veçantë parimit të minimizimit të të dhënave, në mënyrë që të mos përpunohen të dhëna personale më shumë se sa është e nevojshme për realizimin e qëllimit duke mos cenuar natyrën e veçantë të kësaj kategorie subjektsh.

3. Në rastet kur kërkohet pëlqimi për mbledhjen e të dhënave për qëllime marketingu, ai duhet të merret nga prindi ose kujdestari ligjor i të miturit. Kontrolluesi verifikon se prindi ose kujdestari ligjor i tij, është personi që përfaqëson të miturin.

4. Informacioni i nevojshëm duhet t’i vihet në dispozicion të miturit, si dhe prindit ose kujdestarit ligjor të tij. Informacioni që i vihet në dispozicion të miturit, duhet të jetë i përshtatshëm për këtë kategori subjektsh dhe të jetë lehtësisht i dukshëm, i lexueshëm dhe i kuptueshëm.

5. Materialet dhe mesazhet e marketingut drejtuar të miturve, duhet të jenë të përshtatshme në mënyrë që të jenë lehtësisht të dukshme, të lexueshme dhe të kuptueshme dhe të mos cenojnë natyrën delikate personale të të miturve.

6. Prindi ose kujdestari ligjor i të miturit, si përfaqësues ligjor i tij, gëzon të njëjtat të drejta si i mituri, në rolin e subjektit të të dhënave personale.

7. Në rastin kur kontrolluesi mbledh të dhënat e një të mituri, me qëllim pjesëmarrjen në një lojë, ofrimin e një çmimi ose ndonjë veprim tjetër që kërkon shpërndarjen e të dhënave të të miturit, kontrolluesi do të kufizojë përpunimin e të dhënave rreptësisht në masën që është e nevojshme, me qëllim që i mituri të marrë pjesë në këtë aktivitet.

Neni 7

Masat e sigurisë

1. Kontrolluesit përdorin masat e duhura të sigurisë, duke marrë parasysh zhvillimet e teknologjisë së sigurisë dhe kostot, mënyrën e zbatimit dhe sensitivitetin e të dhënave të grumbulluara, për të parandaluar çdo humbje ose shkatërrim aksidental, shpërndarje ose qasje të paautorizuar në të dhënat personale, që përpunohen për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë.

2. Këto masa përfshijnë, ndër të tjera, sigurinë e ndërtesave, në të cilat përpunohen të dhënat personale (përfshirë hyrjet e ndërtesave), listën e personave të autorizuar për të pasur akses në të dhëna, mekanizmat e duhur, masat e sigurisë për transferimin e të dhënave ndërmjet kontrolluesit dhe përpunuesit të të dhënave etj.

3. Kontrolluesit sigurojnë që çdo përpunues që kontraktojnë, garanton një nivel të duhur të masave të sigurisë. Kontrolluesi është përgjegjës ndaj subjekteve të të dhënave për veprimtarinë e përpunuesit, në raport me parashikimet e aktit që rregullon marrëdhënien midis tyre.



Neni 8

Detyrimet për të lehtësuar ushtrimin e të drejtave të subjektit të të dhënave

1. Subjektet e të dhënave gëzojnë të drejtat e parashikuara në nenet 13–20 të ligjit.

2. Kontrolluesi duhet të marrë masa për të trajtuar kërkesat në zbatim të të drejtave të subjekteve të të dhënave duke u kthyer përgjigje brenda 30 ditëve nga marrja e tyre.

3. Subjektet e të dhënave kanë, në veçanti, të drejtën për të marrë informacion nga kontrolluesi:

a) nëse ai po përpunon të dhëna për ta dhe;

b) nëse përpunon të dhëna për ta, të specifikojë kategorinë e të dhënave (përfshirë përmbajtjen e tyre) po përpunohen dhe për cilin qëllim.

4. Në rastin kur të dhënat përpunohen për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë, subjekti i të dhënave ka të drejtën e pakushtëzuar të kundërshtojë përpunimin e të dhënave të tij/saj, me efekt ligjor që kontrolluesi të ndalojë menjëherë përpunimin e këtyre të dhënave për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë.

Neni 9

Dispozita përfundimtare

1. Të gjithë kontrolluesit/përpunuesit publikë dhe privatë në territorin e Republikës së Shqipërisë janë përgjegjës për respektimin dhe zbatimin e këtij udhëzimi.

2. Mosrespektimi i kërkesave të këtij udhëzimi përbën shkelje të ligjit dhe sanksionohet, sipas nenit 94 të tij.

3. Udhëzimi nr. 6, datë 28.5.2010, “Mbi përdorimin korrekt të SMS-ve për qëllime promociionale, reklama, informacione, shitjeve direkte nëpërmjet telefonisë celulare” dhe udhëzimi nr. 16, datë 26.12.2011, “Për mbrojtjen e të dhënave personale në tregtimin e drejtpërdrejtë dhe masat e sigurisë”, shfuqizohen.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E
INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
Besnik Dervishi

KËRKESË

Nr. 112/10, datë 28.4.2025

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i linjës 110 kV Gjiri i Lalzit–Fushë-Kuqe”, me vlerë totale paraprake të shpronësimit prej 630,224.70 (gjashtëqind e tridhjetë mijë e dyqind e njëzet e katër pikë shtatëdhjetë) lekësh.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është OST-ja.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur:

- Për pasuritë e llojit “arë” është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë OST-së, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 630,224.70 (gjashtëqind e tridhjetë mijë e dyqind e njëzet e katër pikë shtatëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Kastriot Gurra

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA
PROJEKTI “NDËRTIMI I LINJËS 110 KV GJIRI I LALZIT-FUSHË-KUQE”

NR. Rendor	NR. Shjyllë	PRONARI			TË DHËNA KADASTRALE					VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM						ADRESA	
		Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose Qyteti	Z. Kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja Totale	"ARË"			"TRUALL"				VLERA TOTALE (lëkë)
										Sipërfaqja (m2)	Çmimi (lëkë/ m2)	Vlera (lëkë)	Sipërfaqja (m2)	Çmimi (lëkë/ m2)	Vlera (lëkë)		
		A	B	C	Ç	D	DH	E	F	L	LL	M	O	P	Q	R	Z
1	1	Thoma		Cuni	Kuraten	2332	242/5	Arë	11734	72.25	397	28,683.25			-	28,683.25	Fshati Kuraten / Nj.A Ishëm / Bashkia Durrës
2	2	Dritan		Agasi	Kuraten	2332	323/26	Arë	2500	70.00	397	27,790.00			-	27,790.00	Fshati Kuraten / Nj.A Ishëm / Bashkia Durrës
3		Lulzim	Tasho		Kuraten	2332	323/35	Arë	136	2.25	397	893.25			-	893.25	Fshati Kuraten / Nj.A Ishëm / Bashkia Durrës
4		Valdete	Ramazan	Zisi													
5	3	Sinan	Islam	Dervishi	Kuraten	2332	243/14	Ullishte	10000	78.73	397	31,255.81			-	31,255.81	Fshati Kuraten / Nj.A Ishëm / Bashkia Durrës
6	4		Shtet		Kuraten	2332	229	Pyll	3625	86.36	-	-			-	-	Fshati Kuraten / Nj.A Ishëm / Bashkia Durrës
7	5		Shtet		Kuraten	2332	228	Pyll	200000	60.84	-	-			-	-	Fshati Kuraten / Nj.A Ishëm / Bashkia Durrës
8	6		Shtet		Kuraten	2332	135	Pyll	118400	37.27	-	-			-	-	Fshati Kuraten / Nj.A Ishëm / Bashkia Durrës
9	7		Shtet		Kuraten	2332	121	Pernisht	2300	37.27	-	-			-	-	Fshati Kuraten / Nj.A Ishëm / Bashkia Durrës
10	8		Shtet		Kuraten	2332	104	Ullishte	2150	94.34	-	-			-	-	Fshati Kuraten / Nj.A Ishëm / Bashkia Durrës
11	9		Shtet		Kuraten	2332	12	Pyll	391000	23.00	-	-			-	-	Fshati Kuraten / Nj.A Ishëm / Bashkia Durrës
12			Shtet		Kuraten	2332	85	Shkëmb	2500	55.73	-	-			-	-	Fshati Kuraten / Nj.A Ishëm / Bashkia Durrës
13	10		Shtet		Kuraten	2332	12	Pyll	391000	37.27	-	-			-	-	Fshati Kuraten / Nj.A Ishëm / Bashkia Durrës
14	11		Shtet		Kuraten	2332	4	Pyll	4541	51.84	-	-			-	-	Fshati Kuraten / Nj.A Ishëm / Bashkia Durrës
15	12		Shtet		Lalez	2375	93	Pyll	151700	37.27	-	-			-	-	Fshati Lalez / Nj.A Ishëm / Bashkia Durrës
16	13		Shtet		Lalez	2375	78	Arë	3000	37.27	-	-			-	-	Fshati Lalez / Nj.A Ishëm / Bashkia Durrës
17	14		Shtet		Kërnushaj	2147	78	Arë	288500	37.27	-	-			-	-	Fshati Kërnushaj / Nj.A Ishëm / Bashkia Durrës
18	15		Shtet		Kërnushaj	2147	78	Arë	288500	7.00	-	-			-	-	Fshati Kërnushaj / Nj.A Ishëm / Bashkia Durrës
19			Shtet		Kërnushaj	2147	80	Truall	1700	-	-	-	30.27	-	-	-	Fshati Kërnushaj / Nj.A Ishëm / Bashkia Durrës
20	16		Shtet		Likmetaj	2453	303	Pyll	266800	60.84	-	-			-	-	Fshati Likmetaj / Nj.A Ishëm / Bashkia Durrës
21	17		Shtet		Likmetaj	2453	295	Arë	76000	68.73	-	-			-	-	Fshati Likmetaj / Nj.A Ishëm / Bashkia Durrës
22			Shtet		Likmetaj	2453	296	Arë	58100	10.00	-	-			-	-	Fshati Likmetaj / Nj.A Ishëm / Bashkia Durrës
23	18		Shtet		Likmetaj	2453	293	Ullishte	3500	60.84	-	-			-	-	Fshati Likmetaj / Nj.A Ishëm / Bashkia Durrës
24	19		Shtet		Likmetaj	2453	275	Pyll	60200	42.25	-	-			-	-	Fshati Likmetaj / Nj.A Ishëm / Bashkia Durrës
25	20		Shtet		Likmetaj	2453	202/5	Arë	179600	39.69	-	-			-	-	Fshati Likmetaj / Nj.A Ishëm / Bashkia Durrës
26	21	Amet	Hamid	Hysa	Likmetaj	2453	193/6	Arë	2200	36.69	397	14,565.93	-	-	-	14,565.93	Fshati Likmetaj / Nj.A Ishëm / Bashkia Durrës
27		Festim	Hamid	Hysa	Likmetaj	2453	193/7	Arë	2030	3.00	397	1,191.00	-	-	-	1,191.00	Fshati Likmetaj / Nj.A Ishëm / Bashkia Durrës
28	22	Bajram	Riza	Kulla	Likmetaj	2453	146/1	Arë	4500	51.84	397	20,580.48	-	-	-	20,580.48	Fshati Likmetaj / Nj.A Ishëm / Bashkia Durrës
29	23	Tomor		Metollari	Likmetaj	2453	157/1	Arë	1500	1.00	397	397.00	-	-	-	397.00	Fshati Likmetaj / Nj.A Ishëm / Bashkia Durrës
30		Kadri	Ismail	Qevani	Likmetaj	2453	157/2	Arë	900	38.69	397	15,359.93	-	-	-	15,359.93	Fshati Likmetaj / Nj.A Ishëm / Bashkia Durrës
31	24	Mehdi	Zenel	Likmeta	Likmetaj	2453	93/1	Arë	13000	46.24	397	18,357.28	-	-	-	18,357.28	Fshati Likmetaj / Nj.A Ishëm / Bashkia Durrës
32	25	Hamdi	Bejulla	Likmeta	Likmetaj	2453	26/12	Arë	14900	42.25	397	16,773.25	-	-	-	16,773.25	Fshati Likmetaj / Nj.A Ishëm / Bashkia Durrës
33	26	Petri	Ali	Kajmaku	Likmetaj	2453	25/5	Arë	7488	42.25	397	16,773.25	-	-	-	16,773.25	Fshati Likmetaj / Nj.A Ishëm / Bashkia Durrës
34	27	Nuk ka informacion					x			56.25	-	-	-	-	-	-	
35	28		Shtet		Shëllinxë	3332	131/13	Arë	42790	46.24	-	-	-	-	-	-	Fshati Shëllinxë / Nj.A Fushë-Kuqe/ Bashkia Kurbini
36	29	Milan	Çun	Jaku	Shëllinxë	3332	130/5	Arë	2933	46.24	278	12,854.72	-	-	-	12,854.72	Fshati Shëllinxë / Nj.A Fushë-Kuqe/ Bashkia Kurbini
37	30	Mark	Ukshin	Rama	Shëllinxë	3332	117/1	Arë	6000	45.24	278	12,576.72	-	-	-	12,576.72	Fshati Shëllinxë / Nj.A Fushë-Kuqe/ Bashkia Kurbini
38				Shtet		Shëllinxë	3332	142/9	Kanal	3293	1.00	-	-	-	-	-	-
39	31		Shtet		Shëllinxë	3332	103/4	Arë	13168	46.24	-	-	-	-	-	-	Fshati Shëllinxë / Nj.A Fushë-Kuqe/ Bashkia Kurbini
40	32		Shtet		Shëllinxë	3332	79/4	Arë	27000	46.24	-	-	-	-	-	-	Fshati Shëllinxë / Nj.A Fushë-Kuqe/ Bashkia Kurbini
41	33	Ndue	Pal	Keraj	Shëllinxë	Arë	79/2	Arë	23000	46.24	278	12,854.72	-	-	-	12,854.72	Fshati Shëllinxë / Nj.A Fushë-Kuqe/ Bashkia Kurbini
42	34	Lek	Fran	Nikaj	Shëllinxë	Arë	68/6	Arë	10000	46.24	278	12,854.72	-	-	-	12,854.72	Fshati Shëllinxë / Nj.A Fushë-Kuqe/ Bashkia Kurbini
43	35		Shtet		Shëllinxë	3332	44/6	Arë	18198	46.24	-	-	-	-	-	-	Fshati Shëllinxë / Nj.A Fushë-Kuqe/ Bashkia Kurbini
44	36		Shtet		Shëllinxë	3332	34/11	Arë	9512	46.24	-	-	-	-	-	-	Fshati Shëllinxë / Nj.A Fushë-Kuqe/ Bashkia Kurbini
45	37	Ndue	Pashk	Curri	Shëllinxë	Arë	34/4	Arë	18151	46.24	278	12,854.72	-	-	-	12,854.72	Fshati Shëllinxë / Nj.A Fushë-Kuqe/ Bashkia Kurbini
46	38	Ilirjan	Gjon	Demiri	Shëllinxë	Arë	4/5	Arë	10000	70.56	278	19,615.68	-	-	-	19,615.68	Fshati Shëllinxë / Nj.A Fushë-Kuqe/ Bashkia Kurbini
47	39		Shtet		Patok	2889	87/10	Arë	4407	46.24	-	-	-	-	-	-	Fshati Patok / Nj.A Fushë-Kuqe/ Bashkia Kurbini
48	40		Shtet		Patok	2889	87/6	Arë	7701	46.24	-	-	-	-	-	-	Fshati Patok / Nj.A Fushë-Kuqe/ Bashkia Kurbini
49	41		Shtet		Patok	2889	66/6	Arë	5287	46.24	-	-	-	-	-	-	Fshati Patok / Nj.A Fushë-Kuqe/ Bashkia Kurbini
50	42	Rakip	Flaxhi	Martinaj													
51		Lavdie	Mujo	Martinaj	Patok	2889	51/9	Arë	9800	40.89	278	11,367.42	-	-	-	11,367.42	Fshati Patok / Nj.A Fushë-Kuqe/ Bashkia Kurbini
52	43		Shtet		Patok	2889	51/10	Arë	12816	4.00	-	-	-	-	-	-	Fshati Patok / Nj.A Fushë-Kuqe/ Bashkia Kurbini
53			Shtet		Patok	2889	50/1	Arë	24042	43.00	-	-	-	-	-	-	Fshati Patok / Nj.A Fushë-Kuqe/ Bashkia Kurbini
54			Shtet		Patok	2889	130/7	Kanal	3059	27.56	-	-	-	-	-	-	Fshati Patok / Nj.A Fushë-Kuqe/ Bashkia Kurbini



55	44			Shtet	Patok	2889	37/1	Kullotë	36529	44.24		-		-		Fshati Patok / Nj.A Fushë-Kuqe/ Bashkia Kurbini
56				Shtet	Patok	2889	36/2	Arë	6194	2.00		-		-		Fshati Patok / Nj.A Fushë-Kuqe/ Bashkia Kurbini
57				Shtet	Patok	2889	12/7	Arë	7419	37.00		-		-		Fshati Patok / Nj.A Fushë-Kuqe/ Bashkia Kurbini
58	45	Shaban	Ramadan	Vuthaj	Patok	2889	12/8	Arë	19545	7.89	278	2,193.42		-	2,193.42	Fshati Patok / Nj.A Fushë-Kuqe/ Bashkia Kurbini
59				Shtet	Patok	2889	98/1	Kanal	5354	37.24		-		-		Fshati Patok / Nj.A Fushë-Kuqe/ Bashkia Kurbini
60	46			Shtet	Patok	2889	98/2	Rrugë	1679	9.00		-		-		Fshati Patok / Nj.A Fushë-Kuqe/ Bashkia Kurbini
61		Rrok	Lulash	Preka	Fushe-Kuqe	1673	1501	Arë	7600	86.25	278	23,977.50		-	23,977.50	Fshati Fushe-Kuqe/ Nj.A Fushë-Kuqe/ Bashkia Kurbini
62	47			Shtet	Fushe-Kuqe	1673	2058	Kanal	11800	4.00		-		-		Fshati Fushe-Kuqe/ Nj.A Fushë-Kuqe/ Bashkia Kurbini
63	48	Gjergj	Pjeter	Huli	Fushe-Kuqe	1673	1990	Arë	8794	50.41	278	14,013.98		-	14,013.98	Fshati Fushe-Kuqe/ Nj.A Fushë-Kuqe/ Bashkia Kurbini
64	49	Rrok	Pal	Palushi	Fushe-Kuqe	1673	1947	Arë	8352	44.89	278	12,479.42		-	12,479.42	Fshati Fushe-Kuqe/ Nj.A Fushë-Kuqe/ Bashkia Kurbini
65	50	Eduart	Luk	Luka	Fushe-Kuqe	1673	1865/5	Arë	25600	90.25	278	25,089.50		-	25,089.50	Fshati Fushe-Kuqe/ Nj.A Fushë-Kuqe/ Bashkia Kurbini
66	51			Shtet	Fushe-Kuqe	1673	1709	Arë	9875	44.89		-		-		Fshati Fushe-Kuqe/ Nj.A Fushë-Kuqe/ Bashkia Kurbini
67	52	Vat	Martin	Vata	Gorre	1812	26/4	Arë	9000	81.00	403	32,643.00		-	32,643.00	Fshati Gorre / Nj.A Fushë-Kuqe/ Bashkia Kurbini
68	53			Nuk ka informacion	Gorre	1812	Gurezi 12			70.56		-		-		Fshati Gorre / Nj.A Fushë-Kuqe/ Bashkia Kurbini
69	54	Gjok	Nikoll	Preli	Gorre	1812	4/11	Arë	5814	90.25	403	36,370.75		-	36,370.75	Fshati Gorre / Nj.A Fushë-Kuqe/ Bashkia Kurbini
SHTESA E NËNSTACIONIT NË FUSHË-KUQE																
70		Gjok	Nikoll	Preli	Gorre	1812	4/11	Arë	5814	486.00	403	195,858.00		-	195,858.00	Fshati Gorre / Nj.A Fushë-Kuqe/ Bashkia Kurbini
71				Shtet	Gorre	1812	4/16	Truall	2288			-	72.00	-		Fshati Gorre / Nj.A Fushë-Kuqe/ Bashkia Kurbini
SHUMA										3,399.52		630,224.70		102.27		630,224.70

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë

